

Financimi i arsimimit dhe i ngritjes së mëtejshme

Sa kushton arsimimi dhe ngritja e mëtejshme në Zvicër?

- Shkolla fillore (përfshirë kopshti i fëmijëve/parashkollorja) dhe niveli sekondar I, pra 11 vjetët e shkollimit të detyrueshëm, për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, të cilët jetojnë në Zvicër, janë falas. Pjesa dërrmuese e fëmijëve në Zvicër ndjekin shkollat publike. Mirëpo, ekzistojnë edhe shkollat private të të gjitha niveleve. Ato kushtojnë, varësisht prej ofertës, pajisjes, publikut të synuar dhe vendit. Shpenzimet për ofertat serioze nuk sillen nën 10'000 deri 15'000 franga në vit (pa banim dhe pa ushqim).
- Në arsimimin bazë profesional, mësimi në shkollat profesionale dhe në kurset jashtë ndërmarrjes janë falas. Në shkollimet praktike në ndërmarrje për mësim të profesionit, nxënësit marrin pagë, varësisht prej profesionit dhe vitit të shkollimit 300,- deri në 1600,- franga në muaj. Nëse arsimimi bazë profesionale bëhet në shkollat e plota shtetërore ose në shkolla të financuara nga shteti, për shembull në shkollat e mesme të tregtisë, mësimi është zakonisht falas. Arsimimi në institucionet private (për shembull në një shkollë të tregtisë) kushton; një arsimim 3-vjeçar në shkollën private të tregtisë kushton rreth 17'000 franga. Në praktikë nxënësit dhe nxënëset marrin rroga të praktikantit, ë cilat zakonisht sillen prej 100 deri në 1000 franga në muaj.
- Gjimnazet dhe shkollat e mesme speciale publike, për të rinjtë të cilët i kanë plotësuar kushtet e pranimit me provim, në shumicën e kantoneve janë falas. Gjimnazet private kushtojnë në vit shumë shtrenjtë: 10'000 deri në 15'000 franga në vit.
- Deri në përfundim të një provimi profesional ose të një provimi të lartë profesional, këto si dy ngritje të mëtejme pas arsimimit bazë profesional, duhet të llogariten me shpenzime prej 10'000 deri në 15'000 franga.
- Në të njëjtat dimensione si në provimet profesionale dhe në provimet të larta profesionale sillen edhe shpenzimet për studime në një shkollë të lartë profesionale.
- Në shkollat e larta universitare publike, kontributi për studime (regjistrimi) kushton midis 1000 dhe 2000 franga në vit. Në institucionet private midis 3'500 deri 5'000 franga; në universitete dhe në shkollat e larta federale teknike ETH, taksat e regjistrimit janë të ngjashme, por mund të shkojnë lart (deri rreth 4'000 franga).

Me rëndësi: Të gjitha shifrat e lartpërmendura janë të përafërta, dhe shërbejnë për ju si ilustrim, se sa kushton arsimimi dhe ngritja e mëtejshme në Zvicër. Numrat mund të dallojnë varësisht prej vendit, institucionit dhe ofertës. Ato mund të jenë më të larta madje shumë më të larta. Ato gjithashtu mund të rriten, d.m.th. mund të ndryshojnë pas një ose dy vjetësh.

Duhet të keni parasysh, që për shembull për një studim në një shkollë të lartë, prej të huajve dhe të huajave kërkohen më shumë taksa për regjistrim, ose për personat të cilët jetojnë në një kanton tjetër dhe studiojnë në kantonin tjetër shpesh duhet të paguajnë një shtesë për arsimimin e tyre. Përveç kësaj, këto janë vetëm shpenzime për ligjërata. Këtyre shpenzimeve mund t'u shtohen shpenzimet për tekstet e mësimi, për material, ekskursione, kampe të shkollës etj. Shkollat private shpesh ofrojnë edhe ushqim dhe banim, që natyrisht menjëherë shkakton shpenzime shumë më të mëdha.

Pra, nëse jeni duke planifikuar të bëni një arsimim ose ngritje të mëtejme, është me rëndësi që së pari t'i mendoni shpenzimet vjetore prej fillimit deri në fund, dhe se a do të jeni në gjendje ta financoni arsimimin ose ngritjen e mëtejme.

Disa oferta janë me korrespondencë krahas me ushtrimin e profesionit, d.m.th. ju studioni dhe një pjesë të kohës punoni dhe fitoni për të siguruar jetën e përditshme dhe financimin e shkollimit. Por, kjo nuk është e mundshme te disa oferta.

Në këto raste duhet të tentoni të gjeni mbështetje financiare. Në shumë raste keni mundësi të parashtroni kërkesa për financim nga shteti në formë të kontributeve për arsimim, bursave apo huave. Mirëpo, ato nuk i mbulojnë të gjitha shpenzimet e jetesës. Edhe institucionet private shpesh japin mbështetje financiare, që të mund të ndiqni arsimimin ose ngritjen e mëtejme. Kontributet shtetërore për shkollim jepen ndonjëherë edhe në formë të kredive (hua). Përderisa bursat jepen si kontribut shtetëror në arsimim, huat duhet të kthehen pas mbarimit të shkollimit, zakonisht me përqindje interesi (kamatë). Edhe institucionet private japin hua, për shembull bankat ose ndërmarrjet për kredi. Mendoni dhe planifikoni mirë, përpara se të merrni kredi (hua): kur dhe me çfarë kushte duhet të ktheni kredinë? Sa është e lartë kamata? Sidomos te kreditë e vogla, përqindjet e interesit janë shpesh shumë të larta; te shteti keni zakonisht kushtet më të mira.

Edhe në çështjet financiare, shfrytëzoni patjetër ndihmën e këshillimoreve profesionale, për studime dhe karrierë. Këshillimoret mund t'ju këshillojnë dhe sipas nevojës të ndërmjetësojnë (për shembull te Qendrat për Këshillime për Bursë), të cilat janë përgjegjëse për përkrahje financiare për arsimim dhe ngritje të mëtejme.

Informacionet

Shiko edhe në <http://stipendien.educa.ch/de> (gjermanisht)